

Portali Prindi & Familja

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka kënaqësinë t'u ofrojë prindërve dhe familjes një mjet, i cili i mban në lidhje me fëmijën e dhe shkollën e tij.

Portali Prindi & Familja, i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ju jep qasje në informacione të vlefshme për edukimin e fëmijës tuaj dhe shkollës.

Nëpërmjet Portalit , shihni arritjet e fëmijës në:



VIJUSHMERINE MËSIMORE



REZULTATET E TESTEVE



FREKUENTIMIN



DHE TË TJERA!



JU MUND TË KENI QASJE NË ÇDO KOHË NGA KOMPJUTERI, TABLETI, OSE CELULARI!

MERRNI NJOFTIME NGA



**TEKST
MESAZHET**



TELEFONATAT



E-MAIL

Ju mund të merrni njoftime për çështje të rëndësishme, që ndikojnë te fëmija juaj (p.sh mbyllja e shkollës për shkak të motit, mungesa në shkollë dhe ngjarje që do të zhvillohen me interes për familjet).

Si mund të regjistrohem për Portalin e Ri Prindi & Familja dhe të krijoj llogarinë time?

Ju duhet të keni një adresë emaili që të hapni llogarinë në Portalin Prindi & Familja. Ju mund të regjistroheni për një email falas në Gmail, Outlook, Yahoo, ose shërbime të ngjashme. Për më tepër informacion si të hapni llogarinë në **Portalin e Prindit, kaloni më poshtë!**



THE SCHOOL DISTRICT OF
PHILADELPHIA

Parent & Family Portal: Le të fillojmë

- 1) KU DUHET TË FILLOJ?**
Vizitoni <http://signup.philasd.org> në browserin tuaj dhe bëni gati **Kodin tuaj të Konfirmimit.**

ÇFARË ESHTË KODI I KONFIRMIMIT?

Kodet e Konfirmimit përdoren për regjistrim nga prindërit dhe kujdestarët. Kodet e Konfirmimit përdoren fillimisht dhe do të humbin vlerën në fillim të çdo muaji. Ju mund t'a merrni Kodin tuaj të Konfirmimit në shkollën e fëmijës, ose mund të regjistroheni plotësisht online!

3) NËSE NUK E KENI KODIN E KONFIRMIMIT TUAJ:

- Klikoni në: Jo, dua të gjej Kodin tim të Konfirmimit.
- Futni informacionin personal të nxënësit tuaj (nëse ju keni më shumë se një nxënës, futni informacion vetëm për një të tillë.)
- Zgjidhni emrin tuaj dhe numrin e telefonit nga rekordet e nxënësit për të kërkuar Kodin e Konfirmimit. Kodi i Konfirmimit mund të dërgohet me mesazh zanor, ose me tekst.
- Tani që e keni Kodin tuaj të Konfirmimit, klikoni Link-un, që të ktheheni në Regjistrimin e Llogarisë (Account Registration) dhe filloni procesin e regjistrimit.

2) NËSE E KENI KODIN E KONFIRMIMIT TUAJ:

- Klikoni në: Po, më çoni në "Regjistrimi i Llogarisë".
- Futni Mbiemrin tuaj dhe Kodin e Konfirmimit. Klikoni: Tjetër. (Next).
- Futni adresën tuaj të email-it.
- Konfirmoni emailin tuaj duke klikuar në link-un që ofrohet në mesazhin e email-it.
- Klikoni në web link-un brënda mesazhit të email_it për plotësimin e regjistrimit tuaj.
- Pas konfirmimit të regjistrimit, ju duhet të shkoni tek Security Settings, ku dhe do të ndërtoni këtë llogari. Zgjidhni një fjalëkalim (password) dhe jepni përgjigjet e tre pyetjeve të sigurisë.
- Futuni në llogarinë tuaj të re me emailin tuaj dhe fjalëkalimin e ri.

NE JEMI TË GATSHËM T'JU NDIHMOJMË!

NA TELEFONONI!

(215) 400-4000

EMAIL!

ask@philasd.org

NA VIZITONI!

philasd.org/pfportal



THE SCHOOL DISTRICT OF
PHILADELPHIA